
LETËRSIA E PARARILINDJES KOMBËTARE NË SHKENCËN LETRARE SHQIPTARE THE LITERATURE OF BEFORE ENLIGHTENMENT IN ALBANIAN LITERARY SCIENCE

ARBEN HOXHA

Instituti Albanologjik i Prishtinës, Dega e letërsisë, Prishtinë, KOSOVË

Email: arbenhoxha69@yahoo.com

AKTET VI, 4: 366 - 369, 2013

PËRMBLEDHJE

Njohja e kuptimit dhe e natyrës së letërsisë së pararilindjes kombëtare ka qenë dhe mbetet një nga detyrat e rëndësishme të shkencës letrare shqiptare. Njohja e natyrës së kësaj letërsie është kusht për njohjen e identitetit letrar shqiptar, si pjesë përbërëse e identitetit kombëtar shqiptar. Pse? Sepse njohja e kuptimit dhe e natyrës së letërsisë së pararilindjes kombëtare përbën nyjen e zotërimit të kuptimit të ekzistencës së të ndryshmeve brenda asaj që është unike dhe të unikes brenda të ndryshmeve brenda sistemit letrar shqiptar. Duke i marrë parasysh mënyrat dhe këndvështrimet nëpërmjet të cilave i është qasur zotërimit të natyrës së kësaj letërsie, në punimin tonë do të bëjmë përpjekje të hedhim dritë mbi kushtet logjike e metodologjike që janë vënë në praktikën e shkencës letrare shqiptare për zotërimin e kuptimit të ekzistencës së kësaj letërsie.

Fjalët çelës: letërsia e pararilindjes, metodologjia, qëllimi i krijuesit, gjuha, vlera estetike.

SUMMARY

Knowing the meaning and nature of before enlightenment literature has been and remains an important task of the Albanian literary science. Knowing of the nature of that literature is provided for the recognition of Albanian literary identity as part of the Albanian national identity. Why? Because knowing of the meaning and nature of the Albanian literature is the knot of mastering meaning of the existence of differenties within unique and the unique within differenties. By the ways and perspectives through which Albanian literary science has approached the nature of mastering this literature, in our paper we will try to shed light on the logical and methodological conditions that are imposed for the existence meaning of this literature.

Key words: Enlightenment literature, methodology, the purpose of the creator, language, aesthetic value.

HYRJE

Të përcaktosh dhe të përkufizosh karakterin dhe funksionin e paradigmeve njohëse të shke--ncës letrare shqiptare, të cilat për objekt të tyre kanë njohjen e letërsisë së pararilindjes ko--mbëtare shqiptare, do të thotë të identi--fi--kosh karakterin dhe përmbajtjen e vizioneve njo--hëse të materializuara në strukturën e gjith--m--barshme të shkencës letrare. Në punimin to--në, duke u bazuar në kritere kognitive tipo--lo--gji--zuese, do të bëjmë klasifikimin e paradig--ma--ve njohëse, me anë të së cilave do të përpi--qemi të hedhim dritë mbi

qëllimet dhe mjetet njohëse, të cilat janë zbatuar në praktikën e shke--ncës letrare shqiptare që për objekt të tyre kanë pasur zotërimin e kuptimit dhe të vlerës së produksionit letrar të pararilindjes kombë--tare shqiptare. 1. Natyra e letërsisë së paralindjes dhe paradigmat e studimit të saj

Në praktikën e shkencës letrare shqiptare përcaktimi i natyrës dhe funksionit të letërsisë së pararilindjes kombëtare do të kondicionohet, në radhë të parë, prej etikës së qëllimeve njohëse të subjekteve njohëse, ashtu sikur që nëpërmjet tyre do të shpaloset ajo etikë.

Varësisht prej përkufizimit që do t'i bëhet natyrës së objektit të studimit të veprave të periudhës së pararilindjes kombëtare do të përcaktohet edhe metoda e studimit të tij, si dhe varësisht prej përkufizimit të natyrës dhe të funksionit të letërsisë së pararilindjes në shkencën letrare shqiptare do të përcaktohen modelet metodologjike të studimit të objekti të saj.

Natyra e letërsisë së pararilindjes kombëtare shqiptare në praktikën e shkencës letrare shqiptare do të përkufizohet si: a) prodhim i gjerave (prodhim i gjuhës, si mjet i identifikimit të etnisë shqiptare); b) si prodhim i kuptimeve për të kaluarën dhe të dijeve të ndryshme; dhe c) si ndërtim i formave dhe kodeve letrare.

Pikënisja e trajtimit të letërsisë së pararilindjes në dy rastet e para, në bazë të përkufizimit të natyrës së letërsisë, do të kondicionohet nga etika e qëllimeve jeshhtëpsistemologjike të subjekteve njohëse (etikë kjo e cila do të shfaqet si vetëdije monolite dhe e padiferencuar), ndërsa në rastin e tretë nga etika metodologjike, e cila do të shfaqet si etikë e diferencuar dhe do të ketë karakter ontologjik relativisht të pavarur. Në këto dy raste interesimi i subjektit njohës do të drejtohet në shqyrtimin e qëllimit të krijuesit, ndërsa në rastin e fundit në fokus do të vihet vetëdija letrare e receptuesit, si kusht i ndërtimit dhe i finalizimit të sistemit të komunikimit letrar.

Në bazë të këtyre pikënisjeve kognitive, në praktikën e studimeve të letërsisë së pararilindjes kombëtare shqiptare do të përvijohen tri modele metodologjike:

- a) modeli pozitivist;
- b) modeli imanetist; dhe
- c) modeli integral.

1.a. Modeli metodologjik pozitivist

Modeli metodologjik pozitivist për shkak se do të bazohet në qëllimin e krijuesit, nëpërmjet analizës filologjike gjuhësore, duke pasur parasysh gjuhën në të cilën është shkruar kjo letërsi, do ta theksojë karakterin kombëtar të saj; dhe në rastin tjetër duke pasur për bazë kriterin e tematik, si kategori sociologjike (*Historia e Skënderbeut*, apo *Rrethimi i Shkodrës* t[Marin

Barletit), do të vihet në pah karakteri kombëtar i kësaj letërsie. Në qoftë se në *Historinë e letërsisë shqipe I-II* vepra e Bogdanit – gjithnjë duke u nisur nga gjuha si fakt empirik dhe si premisë aksiologjike dhe duke e abstraktuar atë nga përmbajta teologjike, filozofike e skolastike që ajo transmeton – do të cilësohet si vepër me ide të rëndësishme për kulturën dhe identitetin kombëtar, ndërsa vetë Bogdani do të kualifikohet si pararendës i rilindësve tanë: “Me këtë dashuri për gjuhën shqipe, me kujdesin për pastërtinë e saj, me këto ide për kulturën kombëtare, që i duhet popullit, Bogdani është pararendës i rilindësve tanë” (Domi & Shuteriqi, I – II 1968: 182).

Idetë për kulturën kombëtare shqiptare nuk mund t'i vishen Bogdanit, sepse në kohën e tij nuk ka ekzistuar kombi, as si koncept politik e as si koncept sociologjik. Rrjedhimisht nuk ka ekzistuar vetëdija politike kombëtare, si amëza e ideve kombëtare.

Në rastin e parë analiza gjuhësore do ta minimizojë interesimin për analizën tematike e përmbajtjesore të kësaj letërsie. Ndërkaq, në rastin e dytë, kur bëhet fjalë për letërsinë e humanistëve, kriteri tematik i analizës, do ta bëjë të pa përfillshëm kriterin gjuhësor-filologjik të interpretimit.

1. b. Dy llojet e modelit metodologjik imanetist

Modeli metodologjik imanetist në shkencën letrare shqiptare në punë të trajtimit të letërsisë së pararilindjes kombëtare, do të bazohet në paradigmen e efekteve që kjo letërsi do të shkaktojë në vetëdijen e marrësit. Për shkak se burimet e këtyre efekteve do të kërkohen në rrafshin e ndërtimit të njërive të veçanta kuptimore, në rastin e parë; dhe në rrafshin e ndërtimit të formave letrare, në rastin e dytë, praktika e hulumtimit të letërsisë së pararilindjes kombëtare shqiptare sipas modelit metodologjik imanetist do të jetë dy llojesh: a) i llojit subjektivist; dhe b) i llojit objektivist.

1.b.1. Modeli subjektivist

Në rastin e parë, njësitë e veçanta kuptimore do të trajtohen jashtë qëllimshmërisë së boshtit

kuptimor të veprës. Një copëzim dhe dekonstruktiv i qëllimshmërisë kuptimore të veprës në njësi kuptimore të veçanta, në praktikën e shkencës letrare shqiptare ka prodhuar konstatime të pa qëndrueshme për karakterin dhe funksionin e veprave të autorëve të veçantë të letërsisë së pararilindjes kombëtare.

Kështu, bie fjala, për kundër vlerësimeve që i hasim në *Historinë e letërsisë shqipe I-II* për rëndësinë e veprës së Bogdanit në ngritjen e vetëdijes kombëtare (gjithnjë duke e ndarë aspektin e rëndësisë gjuhësore të veprës së Bogdanit prej referencës së saj përmbajtjesore filosofike e teologjike), në studimin e Ibrahim Rugovës për veprën e Bogdanit, nëpërmjet metodës së analizës tematike, bëhet përveçimi, shkoqitja, ndarja e përmbajtjes filozofike prej qëllimësisë që asaj ia përcakton përmbajtja teologjike. Për rrjedhojë Rugova Bogdanin do ta fusë brenda një hapësire kundërtënëse klasifikimi, si racionalist, humanist dhe si panteist.

“E po t’i shikojmë qëndrimet e tij mbi problemet themelore të qenies, njohjes dhe njeriut, do të mund të thuhet se në qëndrimet e veta filosofike, Bogdani është racionalist dhe humanist. Racionalist, sepse si çështje kryesore për njohjen e përgjithshme të Zotit, të botës e të njeriut e merr Mendjen, Arsyen, që qëndrojnë në dije (Scienza) dhe Urti (Sapientia)” (Rugova 2007: 565).

Dhe: “Themi se është humanist, sepse në qendër të veprës e ka njeriun dhe për të vazhdimisht flet me bindje dhe adhurim” (Rugova 2007: 566).

1.b.2 Modeli objektivist

Lloji objektivist i modelit metodologjik imanentist, ka për qëllim të vetin njohës e zbulimin e burimeve të efekteve të kënaqësisë artistike, si emocion, që shkakton kjo letërsi. Këto efekte, nëpërmjet semiotikës dhe teorisë së informacionit, lloji objektivist i modelit metodologjik imanentist do t’i kërkojë në strukturat, në funksionet e formave dhe kodeve letrare brenda kësaj letërsie. Kështu, Anton Berishaj me veprën *Retorika dhe letrarësia—teksti i Bogdanit* (Prishtinë 2005), nëpërmjet semiotikës do të insistojë në eksplorimin e kodeve retorike si

kusht i përfuturit dhe i ndriçimit të statusit letrar të kësaj letërsie, e cila, sipas tij nuk shfaqet në fragmente të veçanta, por në tërësinë strukturore të veprës së Bogdanit. Pra, kërkimi i letrarësisë, si qëllim epistemologjik i praktikës së llojit objektivist të modelit metodologjik imanentist të hulumtimit të letërsisë së pararilindjes kombëtare shqiptare, do të jetë antipodi i praktikës së llojit subjektivist të modelit metodologjik imanentist, që bazohet në analizën tematike të kësaj letërsie.

1.b.3. Modeli metodologjik integral

Modeli metodologjik integral prodhimin letrar të pararilindjes letrare do ta vështrijë në prizmin e lidhjeve dialektike që ekzistojnë ndërmjet strukturave të jashtme me ato të brendshme, të sinkronisë me diakroninë; të ndërveprimit të kontekstit të jashtëm në të cilën do të krijohet kjo letërsi me kontekstin e letërsinë e evropiane të kohës, duke e parë ndërvarësinë e zhanreve me kodet letrare, të mjeteve retorike me mesazhin që ato përçojnë tek lexuesi. Një model të tillë për hulumtimin e prodhimit letrar të letërsisë së pararilindjes e ka zbatuar Zeqirja Neziri në studimin e tij *Poezia e Budit* (Shkup 1995).

PËRFUNDIM

Praktika e shkencës letrare shqiptare na provon se për zotërimin e prodhimit letrar të pararilindjes kombëtare shqiptare janë zbatuar dy paradigma njohëse themelore: a) paradigma njohëse, e cila mbështetet në premisën e përcaktimit të qëllimit të krijuesit; dhe b) paradigma njohëse, e cila bazohet në premisën e përcaktimit të efekteve që ka shkaktuar kjo prodhimtari tek marrësi. Zbatimi i këtyre dy paradigmave njohëse, të veçuara njëra nga tjetra, në praktikën e shkencës letrare shqiptare do të sjellin rezultate të pjesshme njohëse dhe, si të tilla, ato nuk mund të shërbejnë si premisa të vetëmjaftueshme për të hedhur dritë mbi identitetin letrar shqiptar

BIBLIOGRAFIA

BERISHAJ, Anton, (2005), *Retorika dhe letrarësia – Teksti i Bogdanit*, Buzuku, Prishtinë.

SHUTERIQI, Dhimitër S. & BIHIKU, Koço & DOMI, Mahir (red.) (1968), Historia e letërsisë shqipe I-II, Universiteti shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë; Enti i botimeve shkollore i RSS, Reparti–Prishtinë, Prishtinë.

NEZIRI, Zeqirja (1995), Poezia e Budit, EkoRitmi, Shkup.

RUGOVA, Ibrahim (2007), Kritika, ASHAK, Prishtinë.,